

UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI I EDUKIMIT

Rr. Agim Ramadani, Fakulteti i Edukimit, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +383 38 229 209 * Email: edukimi@uni-pr.edu * edukimi.uni-pr.edu

Tezat e masterit për diskutim publik të miratuara nga Departamenti i Mësimdhënies në STEM

Me datë 07.07.2026

#	Kandidati	Specializimi	Tema e punimit	Komisioni
1	Sofije Jashari-Berisha	Master i Mësimdhënies lëndore me specializim në Fizikë	Niveli i njohurive të nxënësve sipas Taksonomisë së Bloomit për parimin e punës së makinave të thjeshta në shkollat të mesme të ulëta	kryetar/e Prof ass. Sylejman Berisha mentor/e Prof Skender Kabashi anëtar/e Prof asoc Vlora Sylaj
2	Luljeta Dragaj	Master i Mësimdhënies lëndore me specializim në Kimi	Keqkonceptimet e nxënësve të klasës së 7-të për ndryshimet fizike dhe kimike	kryetar/e Prof asoc Zeqir Veselaj mentor/e Prof asoc Arlinda Damoni anëtar/e Prof ass. Jehona Ferizi – Miftari
3	Amir Arifi	Master i Mësimdhënies lëndore me specializim në Kimi	Njohuritë, qëndrimet dhe sjelljet e nxënësve të shkollës së mesme ndaj substancave të dëmshme për shëndetin dhe mjedisin	kryetar/e Prof asoc Arlinda Damoni mentor/e Prof asoc Fatlume Berisha anëtar/e Prof ass Vjollca Ahmedi
4	Egzona Morina	Master i Mësimdhënies lëndore me specializim në Kimi	Ndikimi i mësimdhënies së bazuar në kërkim për reaksionet kimike	kryetar/e Prof asoc Fatlume Berisha mentor/e Prof asoc Arlinda Damoni anëtar/e Prof ass. Vjollca Ahmedi
5	Arbnore Salihu Ilazi	Master i Mësimdhënies lëndore me specializim në Kimi	Ndikimi i laboratorit virtual në reaksionet kimike organike	kryetar/e Fatlume Berisha mentor/e Arlinda Damoni anëtar/e Prof ass. Vjollca Ahmedi
6	Gëzime Goga	Master i Mësimdhënies lëndore me	Ndikimi i mësimin të bazuar në lojëra digjitale në	kryetar/e Prof ass Fahri Marevci mentor/e Prof Eda Vula

#	Kandidati	Specializimi	Tema e punimit	Komisioni	
		specializim në Matematikë	motivimin dhe shumëzimin	anëtar/e	Prof asoc Kyvete Shatri
7	Hamit Sopaj	Master i Mësimdhënies lëndore me specializim në Matematikë	Analiza regresive lineare e shumëfishtë e faktorëve që ndikojnë në ngritjen e njohurive në fushën e gjeometrisë tek nxënësit e klasës 8-të	kryetar/e mentor/e anëtar/e	Prof ass Fahri Marevci Prof Fitore Abdullahu Prof asoc Vlora Sylaj
8	Meriton Krasniqi	Master i Mësimdhënies lëndore me specializim në Matematikë	Analizë e ndikimit të përdorimit të metodave aktive të të nxënit në përmirësimin e rezultateve në trigonometri në klasat XI	kryetar/e mentor/e anëtar/e	Prof ass Fahri Marevci Prof Fitore Abdullahu Prof Hatixhe Ismajli

Tema:Niveli i njohurive të nxënësve sipas Taksonomisë së Bloomit për parimin e punës së makinave të thjeshta në shkollat të mesme të ulëta

Kandidatja:Sofije Jashari-Berisha

Komisioni:

Prof ass. Sylejman Berisha, kryetar

Prof Skender Kabashi, mentor

Prof asoc Vlora Sylaj, anëtar

ABSTRAKTI

Makinat e thjeshta përbëjnë një pjesë thelbësore të programit të fizikës dhe shkencës në shkollat e mesme të ulëta. Ato përfshijnë levën, rrotën dhe boshtin, pllakatën, vidën, pykën dhe karremin. Qëllimi i këtij hulumtimi është të vlerësohet niveli i njohurive të nxënësve për parimin e funksionimit të makinave të thjeshta, duke u bazuar në nivelet e Taksonomisë së Bloom-it. Rezultatet e studimit kanë ofruar informacione të vlefshëm mbi mënyrën se si nxënësit i kuptojnë konceptet themelore të kësaj fushe, si dhe të nxisin reflektim për përdorimin e Taksonomisë së Bloom-it në planifikimin dhe zbatimin e mësimdhënies në shkencat natyrore. Ky hulumtim do të kontribuojë në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe të nxënies, duke qenë i dobishëm për mësimdhënësit, politikëbërësit dhe studiuesit në fushën e edukimit. Për realizimin e hulumtimit janë përdorur metoda të kombinuara (kuantitative dhe kualitative). Pjesëmarrës në hulumtim kanë qenë 70-të nxënës të klasave 7-ta (mosha 12- 13-vjeç), me përfaqësim të ndryshëm gjinor. Gjithashtu, në studim janë përfshirë edhe tre mësimdhënës të lëndës së fizikës, me nivele të ndryshme përvoja (fillestare, të mesme dhe të avancuar). Të gjithë respondentët janë nga shkolla fillore dhe e mesme e ulët “Dardania” në Prishtinë.

Fjalët kyçe:Makinat e thjeshta, taksonomia e Bloom-it, njohuritë e nxënësve, mësimdhënie në shkencë, aftësitë analitike

Tema:Keqkonceptimet e nxënësve të klasës së 7-të për ndryshimet fizike dhe kimike
Kandidatja:Luljeta Dragaj

Komisioni:

Prof asoc Zeqir Veselaj, kryetar
Prof asoc Arlinda Damoni, mentor
Prof ass. Jehona Ferizi – Miftari, anëtar

ABSTRAKTI

Keqkonceptimet e nxënësve janë një sfidë e zakonshme dhe një pengesë kryesore në mësimdhënien e kimisë, sidomos në njësitet mësimore që lidhen me ndryshimet fizike dhe kimike. Keqkonceptimet mund të çojnë në moskuptim të thellë të koncepteve bazë dhe të ndikojnë negativisht në aftësinë e nxënësve për të interpretuar fenomene kimike dhe fizike në jetën e përditshme. Për këtë arsye, identifikimi dhe analiza e keqkonceptimeve është thelbësore për të përmirësuar kuptimin konceptual të nxënësve dhe për të rritur motivimin e tyre. Ky hulumtim ka për qëllim të identifikojë dhe analizojë keqkonceptimet më të zakonshme të nxënësve të klasës së 7-të lidhur me ndryshimet fizike dhe kimike, si dhe të vlerësojë përhapjen e tyre në një mostër të gjerë. Mostra e hulumtimit përbëhet nga 227 nxënës nga katër shkolla të Prishtinës, për të siguruar përfaqësim të larmishëm të mjediseve arsimore. Metodologjia e përdorur është hulumtim sasior, dhe instrumenti kryesor i mbledhjes së të dhënave është një test, i cili përfshin pohime mbi ndryshimet fizike dhe kimike, me qëllim matjen e nivelit të të kuptuarit të nxënësve dhe identifikimin e keqkonceptimeve të zakonshme. Problemi kryesor që trajtohet në këtë hulumtim është mungesa e kuptimit të saktë të ndryshimeve fizike dhe kimike, prezenca e keqkonceptimeve tek nxënësit dhe ndikimi i tyre në aftësinë për të interpretuar fenomene të thjeshta dhe komplekse kimike dhe fizike. Pyetjet hulumtuese janë: Cilat janë keqkonceptimet më të zakonshme të nxënësve të klasës së 7-të lidhur me ndryshimet fizike dhe kimike? Dhe si ndikojnë këto keqkonceptime në aftësinë e nxënësve për të kuptuar konceptet bazë dhe për të zgjidhur probleme praktike në kimi? Nga ky hulumtim kemi identifikuar gabimet konceptuale më të zakonshme dhe kemi ofruar rekomandime praktike për mësimdhënësit, me qëllim që të përmirësohej mësimdhënia e kimisë, të rritej kuptimi konceptual i nxënësve dhe të zvogëlohej përhapja e keqkonceptimeve. Rezultatet gjithashtu kontribuojnë në përmirësimin e metodave didaktike, të cilat fokusohen në mbështetjen e nxënësve për të kuptuar në mënyrë të qartë dhe të qëndrueshme konceptet kryesore mbi ndryshimet fizike dhe kimike.

Fjalët kyçe:keqkonceptime, ndryshime fizike, ndryshime kimike, nxënës, test

Tema:Njohuritë, qëndrimet dhe sjelljet e nxënësve të shkollës së mesme ndaj substancave të dëmshme për shëndetin dhe mjedisin

Kandidatja:Amir Arifi

Komisioni:

Prof asoc Arlinda Damoni, kryetar

Prof asoc Fatlume Berisha, mentor

Prof ass. Vjollca Ahmedi, anëtar

ABSTRAKTI

Substancat e dëmshme, si detergjentët, mikroplastika, pesticidet dhe tymi i duhanit, paraqesin rrezik të konsiderueshëm për shëndetin e njeriut dhe mjedisin. Niveli i njohurive, qëndrimeve dhe sjelljeve të nxënësve ndaj këtyre substancave ndikon në aftësinë e tyre për të marrë vendim e të sigurta dhe të përgjegjshme në jetën e përditshme. Qëllimi i këtij hulumtimi ishte të analizojë njohuritë, qëndrimet dhe sjelljet e nxënësve të shkollave të mesme lidhur me substancat e dëmshme për shëndetin dhe mjedisin, si dhe të identifikojë dallimet sipas gjinisë dhe shkollës dhe ndikimin e burimeve të informacionit në këto dimensione. Hulumtimi u realizua duke përdorur një qasje sasiore. Të dhënat u mblodhën përmes një pyetësori të strukturuar, të bazuar në instrumentin e Hartmann dhe Klaschka (2017) të përshtatur për kontekstin e studimit. Mostra përfshiu 180 nxënës nga dy shkolla të mesme. Pyetësori përmbante 24 pohime të organizuara në pesë dimensione: interesimi dhe motivimi, njohuritë për substancat e dëmshme, sjelljet dhe veprimet personale, përgjegjësia dhe qasja ndaj informacionit, si dhe burimet e informacionit. Të dhënat u analizuan përmes statistikave përshkruese, t-testit për mostra të pavarura, analizës së korrelacionit dhe regresionit linear. Rezultatet treguan nivel të kënaqshëm të njohurive dhe qëndrime kryesisht pozitive të nxënësve ndaj mbrojtjes së shëndetit dhe mjedisit, megjithëse u identifikuan dallime në disa dimensione sipas gjinisë dhe shkollës. Gjithashtu, burimet e informacionit rezultuan të lidhura me nivelin e njohurive, qëndrimeve dhe sjelljeve të nxënësve. Gjetjet e studimit ofrojnë implikime të rëndësishme për mësimdhënien e kimisë dhe edukimin mjedisor, duke theksuar nevojën për qasje mësimore më të orientuara drejt situatave reale dhe zhvillimit të sjelljeve të përgjegjshme ndaj shëndetit dhe mjedisit.

Fjalët kyçe:substanca të dëmshme, nxënës, njohuri, qëndrime, sjellje, edukim mjedisor

Tema:Ndikimi i mësimdhënies së bazuar në kërkim për reaksionet kimike

Kandidatja:Egzona Morina

Komisioni:

Prof asoc Fatlume Berisha, kryetar

Prof asoc Arlinda Damoni, mentor

Prof ass. Vjollca Ahmedi, anëtar

ABSTRAKTI

Mësimdhënia e bazuar në kërkim përfaqëson një qasje bashkëkohore që e vendos nxënësin në qendër të procesit mësimor, duke e inkurajuar të jetë pjesëmarrës aktiv në ndërtimin e njohurive. Kjo metodë nxit eksplorimin, bërjen e pyetjeve, realizimin e eksperimenteve dhe zbulimin e koncepteve shkencore përmes vëzhgimit, analizës dhe reflektimit. Qasja kërkuese është efektive për përvetësimin e koncepteve abstrakte, të cilat shpesh mbeten të pakuptueshme nëse trajtohen vetëm në mënyrë teorike. Ky hulumtim synoi të analizojë ndikimin e mësimdhënies përmes eksperimentimit me bazë kërkimore në kuptimin e reaksioneve kimike dhe faktorëve që ndikojnë në shpejtësinë e tyre, tek nxënësit e klasës së 11-të në shkollën “Xhevdet Doda”. Nxënësit u angazhuan në aktivitete praktike të bazuara në parime kërkimore, me qëllim zhvillimin e të menduarit kritik dhe përvetësimin e thelluar të koncepteve. Hulumtimi zhvillohet përmes një metodologjie të hulumtimit në veprim, me dizajn kuazi-eksperimental. Instrumentet e përdorura janë paratesti dhe pastesti, për të vlerësuar ndryshimet në njohuri para dhe pas ndërhyrjes mësimore. Pyetja kryesore e hulumtimit është: Çfarë ndikimi ka qasja kërkuese përmes eksperimentit në të kuptuarit e reaksioneve kimike dhe faktorëve që ndikojnë në shpejtësinë e tyre? Rezultatet e këtij studimi tregojnë se qasja e bazuar në kërkim kontribuoi në përmirësimin e të kuptuarit të koncepteve kimike që lidhen me reaksionet kimike dhe faktorët që ndikojnë në shpejtësinë e tyre.

Fjalët kyçe:qasja kërkuese, eksperimentet, reaksionet kimike, faktorët e shpejtësisë së reaksioneve, të nxënit aktiv.

Tema:Ndikimi i laboratorit virtual në reaksionet kimike organike

Kandidatja:Arbnore Salihu Ilazi

Komisioni:

Prof asoc Fatlume Berisha, kryetar

Prof asoc Arlinda Damoni, mentor

Prof ass Vjollca Ahmedi, anëtar

ABSTRAKTI

Ky studim ka për qëllim të analizojë ndikimin e përdorimit të laboratorit virtual në përvetësimin e koncepteve të reaksioneve kimike organike tek nxënësit e shkollës së mesme të ulët. Hulumtimi është realizuar përmes një dizajni kuazi-eksperimental me Para-Test dhe Pas-Test, duke përfshirë një grup eksperimental dhe një grup kontroll. Mostra përbëhej nga 40 nxënës të klasave të teta në dy shkolla në Komunën e Ferizajit. Grupi eksperimental zhvilloi mësimin përmes laboratorëve virtualë, ndërsa grupi kontroll përmes metodës tradicionale të mësimdhënies. Të dhënat u analizuan përmes statistikave deskriptive, testit t për mostra të pavarura dhe testit t për mostra të lidhura, si dhe përmes analizës së korrelacionit. Rezultatet treguan se nxënësit e grupit eksperimental shënuan përmirësim dukshëm më të madh në pas-test krahasuar me grupin kontroll. Diferencat ndërmjet grupeve rezultuan statistikisht domethënëse ($p < 0.05$), duke konfirmuar efektivitetin e laboratorëve virtualë në rritjen e të kuptuarit konceptual. Studimi dëshmoi se përdorimi i laboratorëve virtualë ndihmon në reduktimin e abstraksionit të kimisë organike, rrit motivimin dhe angazhimin e nxënësve, si dhe përmirëson aftësinë e tyre për të kuptuar mekanizmat e reaksioneve. Në përfundim, laboratori virtual rezulton si një mjet didaktik shumë efektiv për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies së kimisë organike.

Fjalët kyçe:laborator virtual, kimi organike, reaksione kimike, simulime digjitale, të nxënësve aktiv

Tema:Ndikimi i mësimit të bazuar në lojëra digjitale në motivimin dhe shumëzimin

Kandidatja:Gëzime Goga

Komisioni:

Prof ass Fahri Marevci, kryetar

Prof Eda Vula, mentor

Prof asoc Kyvete Shatri, anëtar

ABSTRAKTI

Me zhvillimin e teknologjisë në arsim, ka filluar që të ndryshojë edhe mënyra se si fëmijët mësojnë. Duke pasur parasysh vështirësitë që nxënësit hasin në të kuptuarit e konceptit të shumëzimit, përdorimi i qasjeve inovative si lojërat digjitale konsiderohet si një qasje efektive për rritjen e motivimit dhe përfshirjen e nxënësve në procesin e të nxënësve. Hulumtimi synoi të shqyrtojë ndikimin e të mësuarit përmes lojërave digjitale në përmirësimin e aftësive të nxënësve për të kuptuarit e konceptit të shumëzimit, si dhe të shqyrtojë nëse lojërat digjitale ndikojnë në motivimin e nxënësve dhe rritjen e interesit të tyre për lëndën e matematikës. Ky hulumtim në veprim përdori dizajnin para eksperimental, me qëllim të përmirësimit të të kuptuarit të shumëzimit dhe zgjidhjes së detyrave me fjalë me shumëzim përmes përdorimit të lojërave digjitale. Hulumtimi u realizua me nxënësit e klasës së tretë në shkollën fillore dhe të mesme "Zenit" në Prugovc. Paratesti, pastesti, rubrikat e vëzhgimit dhe pyetësi ishin instrumentet matëse për mbledhjen e të dhënave. Rezultatet treguan se lojërat digjitale nuk kishin ndikim pozitiv vetëm në të mësuarit e konceptit të shumëzimit, por edhe në zgjidhjen e detyrave me fjalë me shumëzim, në motivimin e nxënësve dhe në qëndrimet e tyre ndaj matematikës.

Fjalët kyçe:lojëra digjitale, motivim, detyra me fjalë, shumëzim

Tema:Analiza regresive e faktorëve që ndikojnë në njohuritë e gjeometrisë

Kandidatja:Hamit Sopaj

Komisioni:

Prof ass Fahri Marevci, kryetar

Prof Fitore Abdullahu, mentor

Prof asoc Vlora Sylaj, anëtar

ABSTRAKTI

Ky studimi trajton sfidat e të nxënësve të gjeometrisë në klasën e tetë, me fokus në ndikimin e aktiviteteve praktike, mjeteve vizuale, kinestetike, modeleve 3D dhe përdorimit të teksteve e materialeve jashtëkurrikulare në zhvillimin e të kuptuarit të gjeometrisë. Qëllimi kryesor është të identifikojë se cilët prej këtyre faktorëve kontribuojnë më shumë në rritjen e njohurive dhe motivimit të nxënësve për gjeometrinë. Hulumtimi përdor një dizajn me metoda të përziera. Të dhënat sasiore janë mbledhur përmes një pyetësori me 8 pohime me shkallë Likert me 173 nxënës të klasës së 8-të, ndërsa të dhënat cilësore janë marrë nga intervista të strukturuar me shkrim me 7 mësimdhënës të matematikës. Analiza sasiore përfshinë statistika përshkruese, Testin KMO dhe Testin e Sfericitetit të Bartlett, Analizën e Komponentëve Kryesorë (PCA), vlerësimin e besueshmërisë përmes Cronbach's Alpha dhe regresionin linear të shumëfishtë, ku kuptimi i gjeometrisë është matur me një variabël të varur të vetë-raportuar. Të dhënat cilësore janë përpunuar me analizë tematike të përgjigjeve të mësimdhënësve. Rezultatet tregojnë se nxënësit i vlerësojnë veçanërisht lart projektet e botës reale, mjetet vizuale dhe maketet, ndërsa tekstin bazë shkollor dhe materialet jashtëkurrikulare i vlerësojnë më moderuar. Megjithatë, në modelin e regresionit vetëm metodat bashkëkohore me komponent teknologjik dalin parashikues statistikisht domethënës të të kuptuarit të gjeometrisë, ndërsa aktivitetet praktike, maketet dhe teksti nuk shfaqin efekt të pavarur. Intervistat me mësimdhënësit theksojnë rëndësinë shumë të madhe të punës praktike, mjeteve vizuale dhe materialeve shtesë digjitale, duke zbuluar një mospërputhje mes praktikës ideale të përshkruar nga ta dhe përvojës së raportuar nga nxënësit. Në përfundim, studimi tregon se integrimi i qëndrueshëm i teknologjisë dhe metodave bashkëkohore në mësimdhënien e gjeometrisë ka potencial real për të rritur kuptimin e koncepteve, por efektet maksimale arrihen kur këto kombinohen me aktivitete praktike të strukturuar mirë dhe me përdorimin e kujdesshëm të materialeve shtesë jashtë tekstit bazë. Rezultatet sugjerojnë nevojën për planifikim më të balancuar didaktik dhe për mbështetje të mëtejshme profesionale të mësimdhënësve në këto fusha.

Fjalët kyçe:Gjeometria, mjete vizuale, kinestetike, regresioni

Tema:Perceptimet mbi metodat aktive në mësimdhënien e trigonometrisë

Kandidatja:Meriton Krasniqi

Komisioni:

Prof ass Fahri Marevci, kryetar

Prof Fitore Abdullahu, mentor

Prof Hatixhe Ismajli, anëtar

ABSTRAKTI

Pavarësisht rëndësisë që trigonometria ka si për matematikën e shkollave të mesme, ashtu edhe për fizikën dhe shkencat e avancuara, hulumtimet kanë treguar se ajo mbetet një temë sfiduese si për nxënësit, ashtu edhe për mësimdhënësit. Trigonometria ka zbatim jashtëzakonisht të madh në inxhinieri, arkitekturë, orientim në hapësirë dhe astronomi. Megjithatë, edhe pse sipas Kurrikulës së Re të Kosovës, trigonometria fillon të mësohet qysh në klasën e nëntë, përsëri kjo pjesë mbetet sfiduese për ta. Sistemi arsimor në Kosovë ka kaluar përmes vështirësive të panumërta dhe në shkolla janë përdorur metoda tradicionale të mësimdhënies. Sot kemi mundësinë që arsimit t'i pajisë nxënësit me kompetencat që u nevojiten, për ta formësuar jetën e tyre dhe për të kontribuar në shoqëri. Marrëdhëniet midis rezultateve të të nxënësve - procedurave të mësimdhënies dhe të të nxënësve - vlerësimit, përbëjnë atë që në metodologjinë e sotme quhet "trekëndësh magjik". Ky punim synon ta analizojë ndërlidhjen që kanë metodat aktive të të nxënësve në rezultatet dhe arritjet e nxënësve gjatë zhvillimit të mësimin të trigonometrisë në klasat e njëmbëdhjeta. Gjatë realizimit të hulumtimit, vëmendje e veçantë i është kushtuar përdorimit të metodave bashkëkohore të mësimdhënies, si puna në grupe, diskutimet në klasë, zgjidhja e përbashkët e detyrave, si dhe integrimi i mjeteve vizuale dhe teknologjisë në procesin mësimor. Qëllimi i këtij studimi është të shqyrtojë nëse këto forma të punës kanë ndërlidhje në kuptimin më të thellë të koncepteve matematikore nga ana e nxënësve, në përmirësimin e rezultateve të tyre në mësim, si dhe në rritjen e motivimit dhe përfshirjes së tyre gjatë procesit të të nxënësve. Hulumtimi është realizuar duke kombinuar të dhëna sasiore dhe cilësore, me qëllim që analiza e rezultateve të jetë sa më e plotë dhe gjithëpërfshirëse. Të dhënat janë mbledhur nga nxënësit e klasave të njëmbëdhjeta dhe nga mësimdhënësit e matematikës në Gjimnazin "Hamdi Berisha" në Malishevë, përmes pyetësorëve dhe intervistave gjysmë të strukturuar. Përmes këtyre instrumenteve është synuar të sigurohen të dhëna sa më të detajuara dhe reale lidhur me procesin e mësimdhënies dhe të të nxënësve. Analiza është përqendruar në krahasimin e rezultateve të arritura, si dhe në përvojat dhe praktikën që nxënësit dhe mësimdhënësit përjetojnë gjatë procesit mësimor. Nga rezultatet e hulumtimit është vërejtur se përdorimi i metodave aktive ndërlidhet pozitivisht në përmirësimin e rezultateve të nxënësve, por edhe në mënyrën se si ata e kuptojnë dhe e perceptojnë matematikën në përgjithësi. Nxënësit treguan interesim më të madh për mësim, pjesëmarrje më aktive gjatë orës mësimore dhe kuptim më të qartë të koncepteve trigonometrike. Për këtë arsye, ky hulumtim synon të japë kontribut praktik në përmirësimin e procesit të mësimdhënies, duke ofruar ide dhe qasje të zbatueshme për përdorimin sa më efektiv të metodave aktive në klasë.

Fjalët kyçe:metodat e të nxënësve, trigonometria, klasat XI, rezultatet e nxënësve, motivimi, mësimdhënia e matematikës.